



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. _____ Prot./A.Xh

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

B I S E D I M E P Ë R F U N D I M T A R E

“Në lidhje me çështjen (JR) Nr. 56/2024, datë 27.12.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Eranda Laze”

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë **z. Altin Dumani**, si dhe nga prokurori **z. Adnan Xholi** (me autorizim).

Objekti: Bisedime përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancë gjyqësore, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit me Nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, **znj. Eranda Laze**.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: 9.7.2025

Përpara: GJYKATËS KUSHTETUESE

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TIRANË

Faqe 1 nga 13

E nderuar znj. kryesuese e Trupit Gjykses!

Të nderuar gjyqtarë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelim!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqsor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtuan debatit gjyqsor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 20.12.2024, dhe parashtrimeve të seancës së datës 25.6.2025, në mënyrë të përmbledhur vlerëson si vijon:

I. A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Lidhur me pasurinë *Apartament banimi me sipërfaqe 181,2 m², në ***, Tiranë, me vlerë 81.284 euro*, vlerësojmë se, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqsor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 20.12.2024 dhe në parashtrimet e seancës së datës 25.6.2025, lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit gjyqsor në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, dhe nuk ka paraqitur akte apo prova të reja në funksion të këtij shkaku ankimi.

1.1 Në këto kushte, sa i përket konkluzionit të Komisionit mbi momentin e kualifikimit ligjor të personit të lidhur me subjektin, bashkëshortit të saj, dhe detyrimit ligjor të subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruara të përdorura për shlyerjen e kështit të parë të pasurisë, të ardhura të krijuara prej bashkëshortit përpara lidhjes së martesës ligjore, datë **.9.2008, vlerësojmë se:

1.2 Sikundër trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 20.12.2024 dhe parashtrimet e seancës së datës 25.6.2025, mbështetur dhe Rekomandimin e Vëzhguesve Ndërkombëtarë, nga hetimi ka rezultuar se pasuria objekt kontrolli është krijuar nëpërmjet kontratës premtim shitje të datës **.12.2009, pas lidhjes së martesës ligjore të subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur, datë **.9.2008, gjatë ushtrimit të detyrës së subjektit dhe rezulton në bashkëpronësi me pjesë takuese 50%.

1.3 Për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, si dhe për shlyerjen e kështit të parë të saj, referuar mandat arkëtimit të datës **.12.2009, janë deklaruar se janë përdorur *kursimet në shumën prej 40.000 euro*, të cilat ishin deklaruar nga personi i lidhur me subjektin në deklarin e tij të parë në këtë cilësi, në vitin 2008, të poseduara pjesërisht në cash (në shumën prej 30.000 euro) dhe pjesërisht në llogari bankare (në shumën prej 10.000 euro).

1.4 Nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka përdorur pa kundër shpërblim, për periudhën *nëntor 2007 - korrik 2008*, përpara martesës ligjore dhe gjatë ushtrimit të detyrës së subjektit, një apartament në Vlorë, pasuri e blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nëpërmjet “kontratë premtim shitje” të datës ****.4.2008, referuar deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Kjo pasuri, apartament me vendodhje Vlorë, është deklaruar gjithashtu nga subjekti i rivlerësimit edhe në Deklaratën Vetting, si pasuri në posedim dhe si adresë banimi në momentin e plotësimit të deklaratës.

1.5 Lidhja e interesit të subjektit me bashkëshortin përpara martesës, konfirmohet si nga deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ mbi udhëtime të përbashkëta¹, ashtu dhe referuar aksesit të subjektit të rivlerësimit në llogarinë bankare të bashkëshortit, përpara martese, në cilësinë e bashkë mbajtëses së llogarisë².

1.6 Për sa më sipër, vlerësohet se kufijtë e kontrollit të pasurisë së personit të lidhur, që ka shërbyer për krijimin e pasurisë objekt hetimi, kontrolli dhe verifikimi i kursimeve të deklaruara që janë përdorur si burim për blerjen e apartamenteve, duhet t’i nënshtrohen hetimit administrativ për t’i përcaktuar dhe vlerësuar këto sipas parimeve të përcaktuara nga neni 30 i ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin, kanë detyrimin për justifikimin e burimeve të deklaruara të përdorura për krijimin e pasurisë apartament banimi me vendodhje *****, Tiranë, në përputhje me parashikimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të procesit të rivlerësimit.

1.7 Përsa i përket analizës së burimeve të ligjshme të deklaruara se janë përdorur për krijimin e kësaj pasurie, edhe në përfundim të hetimit gjyqësor, vlerësohet se:

1.7.1 Sa i përket burimeve të ligjshme të pagesës së kështit të parë në datë ****.12.2009, në analizë të verifikimit të mundësisë financiare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për të kursyer me të ardhura nga burime të ligjshme, referuar parashikimeve të nenit D pika 3 e aneksit të Kushtetutës, shumën 40.000 euro, deklaruar si kursime në DV-2008, e cila më pas është deklaruar se është përdorur për pagesën e kështit të parë të pasurisë, vlerësohet se në mesin e burimeve të ligjshme të analizës financiare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e këtyre kursimeve, duhet të konsiderohen:

- Të ardhurat e konfirmuara të përfituara nga punësimi në shtetin italian, për periudhën 1998-2004, konfirmuar në vlerën 66.655,27 euro;

¹ Referohuni pyetësorit standard të datës 26.1.2011.

² Bazuar në shkresën e ***** Bank (ish *****) me Nr. ***** Prot., datë ****.9.2024 ka rezultuar akses në llogarinë e **, **. nr. ***** në ***** Bank.

- Të ardhurat e përfituara në formën e dëmshpërblimit në shtetin italian, konfirmuar në shumën 13.652,24 euro;
- Të ardhurat neto të përfituara nga punësimi si jurist pranë ZVRPP Vlorë, për periudhën gusht 2006 - gusht 2007, në shumën 384.209 lekë, konfirmuar me shkresën Nr. *** Prot., datë **.10.2016, e ZVRPP Vlorë;
- Të ardhura neto të përfituara nga punësimi si jurist pranë Njesisë Administrative Orikum, për periudhën shkurt 2008 - dhjetor 2008, në shumën 309.057 lekë, konfirmuar me shkresën Nr. *** Prot., datë **.1.2017, Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Orikum.

1.7.1.1 Të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit pranë shoqërisë “****” sh.p.k., deklaruar në deklaratën Vetting të përfituara për periudhën gusht 2004 - gusht 2006, nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin D pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për sa kohë që mbeti e paprovuar dhe dokumentuar marrëdhënia e punësimit, masa e shpërblimit të përfituar dhe pagimi i detyrimeve tatimore për to dhe si të tilla, në referencë dhe të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit³, nuk duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të personit të lidhur.

1.7.1.2 Bazuar në sa më sipër, të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga emigracioni, të cilat llogariten në shumën totale prej 80.307 euro, vlerësohet se janë të pamjaftueshme për të mbuluar përbalimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit të subjektit për të njëjtën periudhë, llogaritur në shumën prej rreth 33.117⁴ euro, investimet e tij në pasuri të paluajtshme, sikundër rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit në shumën totale prej 58.900 euro⁵, për të njëjtën periudhë, dhe njëkohësisht kursimet e deklaruara në cash në shumën 30.000 euro dhe ato në llogari në bankare në shumën 10.000 euro.

1.7.1.3 Edhe në mbështetje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mbi mundësinë financiare të bashkëshortit, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, investimet dhe kursimet e deklaruara, në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare, nga aktet në dosje rezulton se të ardhurat e ligjshme të dokumentuara të bashkëshortit dhe familjes së

³ Referohuni vendimeve (JR) nr. 23/2020, prg. 24.10; nr. 6/2019, prg. 21.12; nr. 19/2019, prg. 22.13 dhe nr.32/2019, prg. 56; etj.

⁴ Të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 e aneksit të Kushtetutës nga punësimi në shtetin shqiptar në shumën 693.266 lekë, vlerësohet se janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë, referuar të dhënave të konsumit vjetor për frymë sipas shkrësës nr. ***/* prot., datë **.1.2019 të ILDKPKI, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit mbi standardin e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

⁵ Respektivisht apartament me vendodhje Vlorë në vlerën 52.000 euro dhe pjesën takuese prej ½ të pasurisë shtëpi banimi me adresë Durrës në vlerën 875.000 lekë pjesa takuese ½ ose rreth 6.900 euro në vlerën totale prej 58.900 euro.

tij nga punësimi në emigracion për periudhën deri në qershor 2004⁶, llogariten në shumën totale prej rreth 161.268 euro. Këto të ardhura nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar njëkohësisht shpenzimet e jetesës së familjes në shtetin italian në shumën rreth 83.955 euro, investimet në pasuri të paluajtshme rezultuar gjatë hetimit administrativ në shumën rreth 65.800 euro⁷, si dhe kursimet e deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cash dhe llogari bankare në shumën totale prej 40.000 euro.

1.7.1.4 Pretendimet e subjektit, mbi mbulimin tërësisht të shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit nga familjarët e tij, janë pretendime të paraqitura në një fazë të avancuar të hetimit administrativ dhe në funksion të përmbysjes së barrës së provës, dhe si të tilla vlerësohet se janë të pambështetura në aktet në dosje dhe jurisprudencën e Kolegjit.

1.7.1.5 Për sa më sipër arsyetuar, vlerësohet se për sa kohë që nga analiza financiare e personit të lidhur, bashkëshortit, mbeti e paprovuar mundësia e krijimit me burime të ligjshme të kursimeve të deklaruara në vlerën 40.000 euro (në cash dhe në llogari bankare) të cilat janë deklaruar se janë përdorur për pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament banimi me vendodhje ****, Tiranë në datë 22.12.2009, ato nuk duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

1.7.2 Përsa i përket të ardhurave të personit të lidhur, të deklaruara të përfituara nga ushtrimi i veprimtarisë si avokat, për vitin 2009, të ardhura të cilat kanë efekt në analizën financiare të këtij viti, rezulton se referuar legjislacionit të kohës⁸, personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, të cilët realizojnë qarkullim vjetor 2-8 milionë lekë, fashë në të cilën rezulton qarkullimi i aktivitetit të bashkëshortit të subjektit për vitin 2009⁹, janë subjekt edhe i tatimit mbi të ardhurat personale¹⁰, për të cilat është aplikuar tatim në masën 10%.

⁶ Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore dhe atë vetting se burim krijimi i pasurive paluajtshme dhe kursimeve të disponuara janë të ardhurat nga emigracioni për periudhën 1998-2004. Sipas akteve të depozituara, konfirmohen të ardhurat e bashkëshortit të subjektit në shtetin italian deri në datë 30.6.2004.

⁷ Apartament banimi në Vlorë në emër të bashkëshortit të subjektit në vlerën 52.000 euro dhe shtëpi banimi në Durrës në emër të bashkëshortit të subjektit dhe të vëllait të tij, në vlerë 1.750.000 lekë ose rreth 13.800 euro konvertuar me kursin mesatar të vitit të blerjes.

⁸ Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

⁹ Referuar shkresës Nr. ***/* Prot., datë **.10.2024 të Bashkisë Vlorë, të depozituar nga vetë subjekti.

¹⁰ Për vitin 2007 e në vijim, referuar ligjit nr. 9844 datë 17.12.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8438 datë 28.12.1998 Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 12 përcakton se Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale... Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të bizneseve të vogla, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, është 10%.

1.7.2.1 Në gjendjen që janë aktet¹¹, ku akti i depozituar nga vetë subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, konfirmon *vetëm pagesën e taksave të biznesit të vogël dhe ato vendore* pranë organeve përgjegjëse për vitin 2009, në mungesë të konfirmimit të pagesës së detyrimeve tatimore lidhur me qarkullimin e deklaruar¹² sipas fashës takuese, vlerësohet se për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si rezultat i ushtrimit të aktivitetit të avokatisë, për vitin 2009, mbeti e paprovuar në mënyrë ezauruese plotësimi i kushteve të parashikuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

1.7.3 Sa i përket pagesës së kështit të fundit të pasurisë apartament me vendodhje Linzë, Tiranë, në shumën 11.284 euro dhe burimeve të ligjshme të saj, në përfundim të këtij procesi gjyqësor, vlerësohet se mbetën të paprovuara pretendimet e subjektit mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj palës shitëse në vitet 2010 dhe 2013, në kundërshtim me sa provohet me mandatin e arkëtimit të administruar në dosje të Komisionit, mandat datë ***1.2014*, mbi arkëtimin në arkën e shoqërisë të shumës 11.284 euro, nga z. **** ***, me përshkrimin *“Për blerje apartamenti objekti Tiranë, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.*

1.7.3.1 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk gjejnë mbështetje as në aktet në dosje, pasi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 dorëzuar në ILDKPKI, e cila në kuadër të këtij procesi, referuar nenit 32 pika 5, konsiderohet si provë, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri ka deklaruar: *paguar 40.000 euro + 30.000 euro për dy apartamente banimi, (pra një total prej 70.000 euro).*

1.7.3.2 Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar shlyerje detyrimesh ndaj palës shitëse në deklaratimet e mëtejshme pranë ILDKPKI-së, apo edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, përkundër pretendimit të subjektit gjatë hetimit administrativ, se kësti i fundit i pasurisë është shlyer nëpërmjet dy pagesave të mëparshme, respektivisht 10.000 euro në vitin 2010 dhe 1.284 euro në vitin gjatë vitit 2013.

¹¹ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresë nr. ****/** prot., datë ***1.2021*, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit rezulton i regjistruar në organin tatimore DRT Vlorë si “Person Fizik”, duke vënë në dispozicion dhe të dhënat e sistemit C@TS, nga ku rezulton se ky subjekt tatimpagues ka depozituar Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël duke *nisur nga viti 2010*. Ndërkohë subjekti i rivlerësimit, me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, ka depozituar shkresën nr. ****/** prot., datë ***10.2024*, Bashkia Vlorë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, nëpërmjet të cilës konfirmohet pagesa e taksave të biznesit të vogël dhe taksës vendore, të paguara nga ky subjekt i regjistruar si “Person Fizik” për vitin 2009, për xhiron e vlerësuar në shumën 2.100.000 lekë.

¹² Për vitin 2007 e në vijim, referuar ligjit nr. 9844 datë 17.12.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8438 datë 28.12.1998 Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 12 përcakton se Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo me shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale... Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të bizneseve të vogla, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, është 10%.

1.7.3.3 Pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ, se: [...] *përpilimi i mandat arkëtimit të shumës 11.284 euro në vitin 2014, ishte i domosdoshëm për hartimin e kontratës përfundimtare të shitjes, përsa kohë që mungonte dokumentimi me mandat i pagesës 10.000 euro në fund të vitit 2010, si dhe pagesës 1.284 euro në fund të vitit 2013, për këtë arsye para nënshkrimit të kontratës u nënshkrua mandati i datës **.01.2014, sepse mungonte dokumentimi i këtyre pagesave [...] nuk vlerësohet bindës, pasi nga aktet në dosje, rezulton se kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie nga palët, është nënshkruar në datë **.12.2014, rreth 11 muaj mbas datës së mandat arkëtimit.*

1.7.3.4 Gjithashtu, pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ, se: [...] *shuma 10.000 euro për pagesën pjesore të këstit të fundit të këtyre pasurive është paguar në vitin 2010 me burim kursime të deklaruara [...], nuk gjen mbështetje në deklaratet e subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, në të cilën rezulton se kursimet e disponuara deri në këtë moment, të cilat referuar deklarimeve të viteve të mëparshme, 2008 dhe 2009, llogariten në shumën 700.000 lekë, janë deklaruar se janë përdorur për krijimin e një pasurie të paluajtshme, automjetit tip Mercedes Benz, blerë në qershor të vitit 2010¹³.*

1.7.3.5 Bazuar në sa më sipër, vlerësohet se pretendimet e subjektit lidhur me kohën e kryerjes së pagesës së këstit të fundit, vitet 2010 dhe 2013, mbeten në nivel deklarativ e të pambështetura në provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Në këto kushte, vlerësohet se pagesa e këstit prej 11.284 euro, është një shpenzim që duhet të llogaritet për periudhën e dokumentuar sipas mandatit të arkëtimit të administruar në dosje, janar 2014.

1.7.3.6 Lidhur me këtë pagesë, vlerësohet se edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të pagesës së këstit të fundit të pasurisë, në janar të vitit 2014, duke rezultuar në pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për shlyerjen e këtij detyrimi.

2. Analiza financiare për periudhën objekt kontrolli

2.1 Lidhur me analizën financiare, për periudhën objekt kontrolli, *Drejtuesi i Prokurorisë*, vlerëson se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, për sa argumentuar gjerësisht më sipër në trajtimin e pasurisë apartament banimi me vendodhje në Linzë, Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme, *lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për vitin 2008*. Në analizën financiare të kësaj periudhe, përveç kursimeve të deklaruara në cash dhe në bankë, në shumën totale

¹³ Në DV 2010 si burim krijimi i pasurisë Mercedes benz është deklaruar: “kursimet tona”.

prej 40.000 euro¹⁴, trajtuar gjerësisht më sipër në analizimin e burimeve të ligjshme të pasurisë apartament me vendodhje ***, Tiranë, duhet të mbahet në konsideratë edhe sa ka rezultuar gjatë hetimit administrativ, mbi investimet e personit të lidhur në pasuritë e paluajtshme, të deklaruara nga ai në DV – 2008¹⁵, *apartament banimi me vendodhje në Vlorë dhe një shtëpi private me vendodhje Durrës*. Pasuria apartament banimi me vendodhje në Vlorë, fituar nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet kontratës së premtim shitjes datë 9.4.2008, përveçse është deklaruar se është përdorur nga subjekti i rivlerësimit që nga muaji nëntor 2007, përpara lidhjes së martesës ligjore dhe gjatë ushtrimit të detyrës së saj, rezulton se është deklaruar po nga subjekti i rivlerësimit edhe në Deklaratën Vetting, si pasuri në përdorim (apartament në të cilin subjekti banonte në momentin e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës së pasurisë Vetting).

2.1.1 Për sa trajtuar më sipër, në analizimin e pasurisë apartament banimi me vendodhje Linzë, Tiranë, vlerësohet se nga analiza financiare e kryer për vitin 2008, të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, ***nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar investimet, kursimet dhe shpenzimet e jetesës së personit të lidhur me subjektin, për të njëjtën periudhë kontrolli.***

2.2 *Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për vitin 2010, Drejtuesi i Prokurorisë, vlerëson se edhe në përfundim të gjykimit të çështjes në Kolegj, mbetën të paprovuara pretendimet e subjektit mbi transaksionet në llogarinë bankare të përbashkët me bashkëshortin, se shumat e evidentuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, të tërhequra nga kjo llogari bankare (në shumën totale prej 2.948.863 lekë¹⁶), janë veprime që nuk janë kryer nga bashkëshorti i saj dhe shumat e tërhequra nuk duhet të përfshihen në shpenzimet e këtij viti.*

2.2.1 Të paprovuara mbetën dhe pretendimet e subjektit, lidhur me burimet e ligjshme të shumës së depozituar prej 12.249 euro, në këtë llogari pranë *** Bank (ish-***), në datë **.3.2010. Sa i përket pretendimit tjetër të subjektit gjatë hetimit administrativ, se edhe nëse këto depozitime do të ishin kryer nga vetë ajo dhe personi i lidhur me të, do të ishin mbuluar nga kursimet e tyre, nga verifikimi i deklaratave të mëparshme rezulton se kursimet në *cash* të deklaruara të akumuluar deri në fund të vitit 2009, llogariten në

¹⁴ Të deklaruara në DV-2008, se janë deklaruar përdorur për pagesën e kështit të parë të pasurisë së përbashkët.

¹⁵ Në deklaratën e interesave periodike vjetore, dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2008, në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

¹⁶ Për të cilat, subjektit, me rezultatet e hetimit administrativ ju kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimet e ligjshme të shumave të kredituara në llogarinë bankare për periudhën **.3.2010-**.6.2010, në vlerën rreth 23.749 euro dhe destinacionin e përdorimit të shumave të debituar në vlerën rreth 21.250 euro.

vlerën totale 700.000 lekë¹⁷, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të krijuar shumën e depozituar prej 12.249 euro, duke afektuar burimet e ligjshme të tyre.

2.3 *Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për vitin 2014, Drejtuesi i Prokurorisë*, për sa argumentuar gjerësisht më sipër në analizimin e burimit të pagesës së kështit të fundit të pasurisë apartament banimi me vendodhje në ***, Tiranë, vlerëson se për sa kohë mbetën të paprovuara pretendimet e subjektit mbi kryerjen e pagesave të këtij kështi në vitet 2010 dhe 2013, në analizën financiare të vitit 2014, në zërin shpenzime duhet të përfshihet dhe pagesa e kështit të fundit të pasurisë, në vlerën 11.284 euro referuar mandat arkëtimit të administruar në dosje, shpenzim që do të afektonte rezultatin financiar të vitit 2014.

3 Bazuar në sa më sipër dhe për sa trajtuar gjerësisht dhe në ankimin e datës 20.12.2024 dhe rekomandimin e ONM-së datë 6.12.2024, *Drejtuesi i Prokurorisë*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e pasurisë, referuar kërkesave të parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

I. B Çështje të tjera

4 *Lidhur me pasurinë Tokë me sipërfaqe 500 m² ndodhur në ***, Vlorë*, vlerësojmë se, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 20.12.2024 dhe në parashtrimet e datës 25.6.2025.

4.1 Gjatë seancës dëgjimore të datës 25.6.2025 në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë akt apo provë të re lidhur me këtë shkak ankimi, si dhe në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Relatori i çështjes lidhur me këtë pasuri, nuk ezauroi apo provoi pretendimet e saj mbi shërbimin/konsulencën e ofruar nga bashkëshorti, në kuadër të të cilit është përfituar dhurimi i kësaj pasurie.

5 *Lidhur me Ndërtimin informal në proces legalizimi (nga babai i bashkëshortit të subjektit), në Dhërmi*, në seancën e datës 25.6.2025, Kolegji administroi në cilësinë e provës, aktin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, Deklaratë noteriale Nr. *** Prot., datë **.6.2025 të shtetasit **.**, në të cilën ky i fundit, deklaroi se *objekti informal, ndodhur në Dhërmi, është ndërtuar në tokën e familjes Konomi dhe se ai, bashkëshortja e tij dhe shtetasi *** ***, nuk kanë asnjë lidhje me këtë objekt.*

¹⁷ Referuar arsyetimit të Komisionit “Në lidhje me pagesën e 10 mijë euro dhe lidhur me transaksionet e kryera në llogarinë bankare në *** Bank”, f. 19-20 të Vendimit.

5.1 Gjatë seancës gjyqësore të datës 25.6.2025 në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, sa i përket konstatimit mbi mosprezencën e të vjehrrit, shtetasit **. **. në shtetin Shqiptar në datën 3.10.2014, datë e dorëzimit të “Deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit”, parashtroi se, deklarata e legalizimit nuk është firmosur nga shtetasi **. **. dhe në asnjë moment nuk është deklaruar ndryshe dhe se ndërtimi informal nuk është kryer me punë vullnetare, çka do të kërkonte detyrimisht prezencën e të vjehrrit në shtetin Shqiptar përgjatë vitit 2008. Po në vijim të debatit gjyqësor, në përgjigje të pyetjeve të Relatorit të çështjes, subjekti i rivlerësimit, gjithashtu deklaroi se nuk është vazhduar më tej me ndërtimin e këtij objekti, për shkak të qasjes së saj si prokurore kundrejt veprës “Ndërtim i paligjshëm”.

5.2 Në përfundim të hetimit gjyqësor, për sa rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit në raport dhe me qëndrimin e subjektit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, vlerësohet se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje, nuk konsiderohen bindëse në drejtim të shpjegimit/qartësimit të situatave të rezultuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

6 Për sa më sipër, *Drejtuesi i Prokurorisë* vlerëson se edhe në përfundim të gjykimit të çështjes në Kolegj, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse në raport me aktet në dosje dhe subjekti i rivlerësimit, duket se është përpjekur të paraqesë ndryshe situatat faktike lidhur me çështjet e mësipërme, në drejtim të besueshmërisë së deklarimeve të saj, situata këto të cilat duhen rishikuar në vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

II.A Lidhur me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale

7 Lidhur me të dhënat e rezultuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit sa i përket kontakteve me shtetasin *** **¹⁸, fillimisht sjellim në vëmendje se, sikundër referuar dhe nga Relatori i çështjes, në seancën e datës 25.6.2025 në Kolegj, nga aktet në dosje ka rezultuar që dosja penale nr. ***/2012 është protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit në datën **.10.2024, një ditë pasi ky i fundit kishte marrë vendimin për mbylljen e hetimit administrativ, datë **.10.2024, duke mos u trajtuar dhe analizuar në kuadër të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit znj. Eranda Laze. Gjithashtu, sikundër kemi pohuar edhe gjatë seancës gjyqësore në Kolegj, në aktet e

¹⁸ Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, kanë udhëtuar në datën **.11.2015, me shtetasin *** ** dhe bashkëshorten e tij, ndërsa vetë bashkëshorti i subjektit ka udhëtuar me këtë shtetas, më datë **.2.2016.

administruara në fashikullin e disponuar nga Komisioneri Publik lidhur me këtë çështje, dosja penale nr. ***/2012, nuk rezulton të jetë përcjellë e plotë.

7.1 Në referencë të shkaqeve të ankimit lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar mungesën e dijenisë për procedimin penal nr. *** të vitit 2012 ndaj shtetasit *** ***, duke elaboruar dhe moskualifikimin e këtij shtetasi si kontakt i papërshtatshëm. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu ka deklaruar se formulari i dekriminalizimit ose deklarata për kontrollin e figurës, është plotësuar në vitin 2017, përpara procedimit tjetër penal ndaj shtetasit të mësipërm, në vitin 2018.

7.2 **Drejtuesi i Prokurorisë**, në referencë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, pas verifikimit të akteve në dosjen përkatëse të procedimit penal nr. ***/2012, administruar nga Kolegji në seancën e datës **.6.2025, vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit **konsiderohen bindëse** në raport me mungesën e dijenisë mbi procedimin penal ndaj shtetasit **.***., në kushtet kur rezultoi e provuar se emri i këtij shtetasi nuk rezulton të ishte regjistruar në Regjistrin e Veprave Penale të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjithashtu, edhe nga verifikimi i fashikullit të administruar në Kolegj, rezultoi se procedimi penal nr. ***/2012 ishte trajtuar nga prokurorë të tjerë pranë kësaj prokurorie, deri me pushimin e çështjes në vitin 2015.

II B Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale dhe tërësor të procedurave

8 Për sa i përket çështjeve të tjera të trajtuara në ankimin e datës 20.12.2024 dhe parashtrimet në seancën gjyqësore të datës 25.6.2025, lidhur me të dhënat e rezultuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit referuar sistemit TIMS, mbi udhëtime të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti të saj me: (i) një automjet në përdorim të shtetasit *** ***; (ii) udhëtime të bashkëshortit të saj me shtetasin *** *** gjatë periudhës kohore 2017 – 2020 si dhe (iii) udhëtime me shtetasin *** ***¹⁹, për të cilat subjektit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar barrën e provës gjatë hetimit administrativ, vlerësohet se:

8.1 Edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se udhëtimet janë kryer për qëllime pune të bashkëshortit dhe duke referuar të njëjtat akte zyrtare të

¹⁹ Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar në disa raste gjatë viteve 2019-2020, me vëllain e *** ***. Shtetasi *** ***, gjithashtu, ka rezultuar se ka depozituar 500 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, më datë **.1.2019.

administruara gjatë këtij hetimi²⁰, si dhe ka pretenduar se procedimet penale ndaj këtyre shtetasve i përkasin periudhave pas udhëtimeve të identifikuara.

9 Lidhur me mbulimin e disa shpenzimeve të udhëtimeve të subjektit të rivlerësimit nga agjencitë e udhëtimeve detare, përkatësisht “*** ***” sh.p.k dhe “****” sh.p.k, ***megjithëse në mungesë të konfliktit të interesit***, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të një kujdesi të shtuar në veprimtarinë e saj jashtëgjyqësore, e cila ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit.

10 Drejtuesi i Prokurorisë, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së të datës 6.12.2024, duke pranuar dhe njohur natyrën dhe vështirësinë e ekuilibrit që duhet të vendoset ndërmjet punës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si avokat në fushën e të drejtës penale, ushtrimit të ligjshëm të profesionit të tij, në shumicën e rasteve në të njëjtin rreth ku subjekti i rivlerësimit punon si prokurore dhe përmbushjes së kërkesave ligjore në fuqi për sjelljen e një magjistrati brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në tregimin e një kujdesi të shtuar në veprimtarinë e saj jashtë-gjyqësore, sjellje këto që vijnë në kundërshti me sa parashikohet në nenin 3, pika 5 të ligjit nr. 96/2016²¹, dhe udhëzimet ndërkombëtare, që rregullojnë sjelljen e magjistratëve, si brenda, ashtu edhe jashtë sistemit gjyqësor²².

II. KËRKIMI I PËRFUNDIMTAR

11 Drejtuesi i Prokurorisë, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 20.12.2024, dhe parashtrimeve të seancës së datës 25.6.2025, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”,

²⁰ Shkresë Nr. *** Prot., datë **9.2024 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sipas së cilës procedimi penal ndaj shtetasit **,**, për veprën penale parashikuar nga neni 287 i KP, i përket vitit 2021, dy vite më vonë nga udhëtimi i përbashkët me subjektin, në vitin 2019. Gjithashtu sa i përket shtetasve **,**, **,** dhe **,**, subjekti i rivlerësimit ka risjellë në vëmendje se referuar informacionit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndaj këtyre shtetasve nuk ka patur dhe nuk ka të regjistruar ndonjë çështje penale.

²¹ [...] 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi.[...]

²² https://***.***.int/168074738b [...] 6. Prokurorët duhet të respektojnë standardet më të larta etike dhe profesionale, duke u sjellur gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe objektive. 97. Prokurorët duhet të fitojnë besimin e publikut duke treguar një sjellje shembullore në të gjitha rastet. Ata duhet të trajtojnë njerëzit në mënyrë të drejtë, të barabartë, me respekt dhe mirësjellje. Gjithashtu, ata duhet të respektojnë gjithmonë standardet më të larta profesionale dhe të ruajnë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre, duke vepruar gjithmonë me integritet dhe kujdes [...].

të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze.

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Adnan XHOLI